

## **Fëmija im do të shkojë në kopështin e fëmijëve**

### **Përmbajtja**

<b>Mirsevini në kopështin e fëmijëve</b>	<b>04</b>
<b>Kopështi i fëmijëve si vënd përvoje dhe mësimi</b>	<b>05</b>
<b>Si mësojnë fëmijët</b>	<b>06</b>
<b>Kompetencat</b>	<b>07</b>
<b>Plani mësimor në kopështin e fëmijëve në Niederösterreich</b>	<b>08</b>
<b>Portfolio në kopështin e fëmijëve</b>	<b>09</b>
<b>Fushat arsimore, emocionet dhe marrdhënjet shoqërore</b>	<b>11</b>
<b>Etika, feja dhe shoqëria</b>	<b>13</b>
<b>Gjuha dhe komunikimi</b>	<b>15</b>
<b>Lëvizja dhe shëndeti</b>	<b>17</b>
<b>Estetika dhe ndërtimi</b>	<b>19</b>
<b>Natyra dhe teknika</b>	<b>21</b>
<b>Kolektivi i kopështit të fëmijëve</b>	<b>23</b>
<b>Përgjegjësit në Gemeinde</b>	<b>24</b>
<b>Pyetjet për kopështin e fëmijëve</b>	<b>25</b>
<b>Literatura</b>	<b>26</b>

Të dashur prindër!

Kopështi i fëmijëve, është një vënd i rëndësishëm i mësimdhënjes, që do tju ndihmojë juve në edukimin dhe kujdesjen e fëmijës tuaj. Pedagogët dhe kujdestarët, do të shoqërojnë me përgjegjësi e angazhim të lartë si dhe me dashuri e dhimsuri fëmijën tuaj, në periudhën formuese të viteve të para të jetës.

Me kopështin e fëmijëve që paradite është gratis, me impulset pedagogjike dhe shoqërimin e zhvillimit të fëmijës tuaj me Portfolio, me ofensivën gjuhësore të anglishtes dhe në zonat kufitare të gjuhës çeke, sllovae, hungareze si dhe me pedagogjinë interkulturore, kopështi i fëmijëve në Niederösterreich ju afron shumë mundësira dhe impulse mësimore për fëmijën tuaj.

Në qëndër të vëmëndjes qëndron zhvillimi më i mirë dhe më individual i fëmijës tuaj, që do të ndihmohet prej ofertave pedagogjike të shumëllojshme, përvojës dhe kontaktit në fushat sociale dhe emocionale. Ju si prindër, keni mundësinë që me anë të bllokut **Mein Kindergarten Portfolio**, që do të shoqërojë fëmijën tuaj gjatë gjithë periudhës kopështore, të merrni pjesë aktive dhe të shoqëroni fëmijën tuaj në zhvillimin e aftësive ,të dhënave dhe talenteve të veta.

Kjo broshurë do tju shërbejë si informacion, për tju treguar këto mundësi të shumta në kopështin e fëmijëve.

Unë do të dëshiroja, që këtë moment të falemnderoja për zemërsisht të gjithë ata njerëz që punojnë aktiv dhe plot angazhim, në interes të fëmijëve tanë. Unë i uroj gjithashtu fëmijës tuaj, një kohë të lumtur, të pashqetësuar dhe plot aktivitet në kopështin e fëmijëve.

MAG. BARBARA SCHWARZ

Landesrätin

## **Mirsevini në kopështin e fëmijëve**

„ Dhe në çdo fillim, banon brënda një magji...“ (Hermann Hesse)

Hyrja në kopështin e fëmijëve është fillimi i një pjese të re të jetës, që e mbushur me përvojë dhe përjetësime, do ti hapi fëmijës tuaj mundësira të gjithanëshme të mësimi dhe jetës. Kalimi nga familja në botën e re kopështore, i kërkon fëmijës tuaj të mësohet dhe përshtatet me kushtet e reja atje. Fëmija juaj kërkon kohë për tju përshtatur situacioneve të reja, vëndqëndrimin të ri si dhe ambjentimit me një sistem të ri ditor. Fëmija juaj do të ndahet përkohësisht nga personat e familjes së tij, do të njohë fëmijë dhe të rritur të tjerë dhe do të ndërtojë marrdhënje të reja me ta. Fëmija juaj do ta zotërojë ngadalë këtë botë të re, deri tani të panjohur për të dhe do të mundohet të bëhet gjithmonë e më i vetvendosur në veprimet e veta .Ky është një hap i rëndësishëm për pavarësinë e tij.

Për hapat dhe takimet e para me këtë botë të re, jeni të udhëzuar të frekuentoni në orë të caktuara kopështin e fëmijëve. Ditën dhe orën, do ta bisedoni paraprakisht me drejtorinë e kopështit. Në këtë takim do tju jepet mundësia, që sëbashku me fëmijën tuaj të mblidhni të dhënat e para në drejtim të njohjes me kopështin.

Kërkesat e fëmijëve në fillimet e veta në kopësht, ndryshojnë nga njëri tek tjetri.Ju lutem të bisedoni me pedagoget dhe kujdestaret kopështit, për periudhën e parë të çuarjes si dhe të marrjes nga kopështi, me qëllim që fëmija juaj të fitojë besimin si dhe ju të jeni të qetë që ai ndjehet mirë aty.

## **Kopështi i fëmijëve si vënd përvoja dhe mësimi**

Kopështi i fëmijëve është një institucion mësimi për fëmijët e moshës 2,5 - 6 vjeç, që do tju ndihmojë juve si prindër për të rritur, edukuar dhe zhvilluar fëmijën tuaj.

Për ne është e rëndësishme, që çdo fëmijë të ndihmohet me të gjitha mundësitë në zhvillimin e tij të gjithanshëm, me kompetencat, të dhënat si dhe përparësitë mësimore të tij .

Bazë për shoqërimin dhe ndihmesën pedagogjike të fëmijëve në formën e lojës, është plani mësimor për kopështin e fëmijëve në Niederösterreich. Një fushë e gjërë me impulse të gjithanëshme pedagogjike dhe mësimore të cilat i drejtohen marrdhënjeve sociale dhe emocionale, etikës dhe shoqërisë, gjuhës dhe komunikimit, lëvizjes dhe shëndetit, estetikës dhe ndërtimit, natyrës dhe teknikës, do të sigurojë një kualitet të lartë të shkollimit të të gjithë fëmijëve.

Nëpërmjet lojrave dhe materialeve mësimore tepër qualitative si dhe sugjerimeve të shumë llojshme, fëmijët do të motivohen për aktivizimin e tyre në këto drejtime si dhe do të zgjohen dhe ndihmohen interesat e tyre. Është çështje kryesore për ne, që fëmijët të ndihmohen në aktivitetet e tyre, me qëllim që ata të mësojnë dhe përjetojnë sa më shumë, me qëllim që të veprojnë sa më aktiv dhe të vetëdijshëm, me qëllim që të jenë krenarë për çfarë kanë arritur, si dhe me qëllim që të motivohen për të zgjeruar sa më shumë dijenitë e tyre. Të qenit kureshtar, e ndihmon fëmijën për të mësuar më tepër. Sëbashku me shokët dhe shoqet gjatë lojës, fëmija do të motivohet dhe ndihmohet akoma më shumë për procesin mësimor. Vëmëndja, koncentrimi, kontaktet shoqërore, deklarimi i interesave të veta, si dhe vëmëndja për të tjerët, janë tema qëndrore të procesit mësimor në kopështin e fëmijëve. Të dhënat dhe kërkesat individuale të fëmijëve, janë në qëndër të punës tonë pedagogjike. Nëpërmjet punës sistematike pedagogjike me Portfolio, do të bëhen të qarta si për ju, ashtu dhe për fëmijën tuaj, përparësitë dhe hapat e zhvillimit të tij.

Nëpërmjet dhe sëbashku me të gjithë fëmijët që vinë nga kultura të ndryshme, do të rritet mirkuptimi për një shoqëri shumëkulturore si dhe do të ndihmohet njohja me gjuhë të tjera. Për ne është shumë e rëndësishme që fëmija juaj të ndihet sa më mirë në kopështin e fëmijëve si dhe dhënja e mundësive optimale për të shpalosur aftësitë dhe të dhënat individuale të çdo fëmije.

## Si mësojnë fëmijët

„Arti i madh është ai, që gjithçka që fëmijët duhet të bëjnë ose mësojnë, ta bëjnë në formën e lojës“. (John Locke)

Proçeset mësimore përbëjnë bazën e arsimimit: Përmes kureshtjes, eksperimenteve, vetshërbimit, mësimin përmes zbulimeve, mësimin me model si dhe mësimin gjatë lojës, fëmijët fitojnë vazhdimisht dijeni të reja si dhe përvojë rreth vetes dhe ambientit që i rrethon. Kjo çon në një zhvillim të vazhdueshëm të botkuptimit si dhe të zgjerimit të aftësive të veprimit të tij.

Këndshikimi i arsimimit të fëmijëve në moshë të vogël, qëndron në zhvillimin e kompetencave, sepse proçeset mësimore në moshë të vogël, kanë prioritet të lartë, por megjithatë forma më e rëndësishme e të mësuarit në këtë moshë, është ajo e lojës.

Një bazë e rëndësishme e rrjedhjes së proçeseve mësimore, formon gjithashtu edhe një marrdhënie të sigurt dhe të besuar me personat e rritur. Ajo është kusht paraprak, që fëmija të jetë i gatshëm për të përvetsuar gjithçka të re, si dhe të bëhet i vetëdijshëm për botën që po përjeton.

- **Mësimi është një proçes aktiv.** Me qëllim që përmbajtjet e reja të mësohen dhe të mbahen mend, duhet që ato të kenë lidhje me atë çka është mësuar më parë.
- **Mësimi kërkon përfshirje të brëndëshme.** Përmbajtja mësimore duhet të orientohet nga interesat e fëmijëve.
- **Mësimi kërkon vëmëndje.** Sa më me intensivitet ti kushtohemi një teme, aq më të vëmëndshëm do të jemi kundrejt saj dhe aq mirë do të regjistrohet përmbajtja e saj.
- **Mësimi kërkon motivacion.** Në mësojmë, kur përmbajtja e asaj që duhet mësuar është interesante.

## **Kompetencat**

Zhvillimi i kompetencave është bazë themelore për të përballuar të gjitha detyrat tona jetësore.

Me **kompetenca** do të nënkuptojmë një rrjet të gjërë prej njohurish, dijenish, aftësish si dhe strategjish, që gjatë procesit mësimor na nevojiten për të qënë në gjëndje të përballojmë situacionet e ndryshme.

Fëmijët zhvillojnë në marrdhënjen e tyre të përbashkët me botën që i rrethon, kompetenca në kuptimin e **vetkompetencës, kompetencës sociale** si dhe **kompetencën e dijenive**.

Me **vetkompetenz** nënkuptojmë një vetëkoncept pozitiv, pavarësinë, iniciativën vetvepruese dhe aftësinë për të qënë vetë përgjegjës për veprimet e bëra.

Me **kompetencë sociale** nënkuptojmë aftësinë dhe gjykimin e veprimit në marrdhënjet shoqërore. Midis të tjerave, bazë për këtë është përvoja për tu bërë i njohur, përkatësia në një grup të caktuar dhe përgjegjësia e përbashkët. Të ndjerit me njerzi dhe për njerzit e tjerë, aftësia për të bashkpunuar si dhe njohja dhe mbajtja e rregullave, janë disa elemente të tjera të kompetencës sociale.

**Kompetenca e dijenive** përfshin aftësinë dhe gjykimin për drejtimit e ndryshme të dijenive.

Trajtimi i objekteve dhe materialeve, kuptimi gjuhësor i sendeve si dhe ndërlidhja midis tyre përbëjnë bazën kryesore në këtë drejtim.

Me **kompetencën metodike të të mësuarit** nënkuptojmë në rradhë të parë, zhvillimin e ndërgjegjësimit të vetëproçeseve mësimore si dhe strategjitë ndihmuese të të mësuarit.

**Metakompetencë** nënkupton aftësinë e të mësuarit dhe të vlerësuarit, të gradës së zhvillimit të të gjitha kompetencave personale si dhe zbatimin e tyre në situacione të ndryshme. Këto dijeni për veteveten bëjnë të mundur edhe zgjidhjen e detyrave akoma më të vështira.

## **Plani mësimor në kopështin e fëmijëve në Niederösterreich**

### **Plani mësimor**

- jep një kontribut të rëndësishëm, në transparencën e punës mësimore dhe procesit mësimor në kopështin e fëmijëve
- afron një kuadër orientimi profesional, për punën pedagogjike me fëmijët
- përmban sugjerime pedagogjike dhe metodike për punën në praktikë
- ndërton urën e kalimit, nga kopështi i fëmijëve në shkollë

Drejtimet arsimore të përmendura në planin mësimor, do të gjejnë në faqet e mëposhtëme përshkrime, sugjerime dhe shëmbuj, se si do të ndihmohen fëmijët në zhvillimin e tyre të gjithanshëm.

### **Drejtimi arsimor**

Marrdhënjet sociale dhe emocionale

Faqe 11

### **Drejtimi arsimor**

Etika, feja dhe shoqëria

Faqe 13

### **Drejtimi arsimor**

Gjuha dhe komunikimi

Faqe 15

### **Drejtimi arsimor**

Lëvizja dhe shëndeti

Faqe 17

### **Drejtimi arsimor**

Estetika dhe ndërtimi

Faqe 19

### **Drejtimi arsimor**

Natyra dhe teknika

Faqe 21

## **Portfolio në kopështin e fëmijëve**

„Arti i madh është ai, që gjithçka që fëmijët duhet të bëjnë ose mësojnë, ta bëjnë në formën e lojës“. (John Locke)

### **Çfarë nënkuptojmë me Portfolio ?**

Portfolio bën të dukshme hapat e zhvillimit, talentet, dhe aftësitë e fëmijës tuaj.

### **Nga çfarë përbëhet Portfolio?**

Portfolio përbëhet nga **Entwicklungsportfolio (Portfolio e zhvillimit)**, **Übergangsportfolio (Portfolio kalimtare)** „Schatzkiste“(Kutia e thesarit)

#### **Portfolio e zhvillimit**

- . dokumenton kompetencat, të dhënat, dhe proceset zhvilluese të fëmijës tuaj
- . ndihmon proceset e reja mësimore dhe mendore
- . i bën rrugët mësimore të dukshme
- . zbatohet nga fëmija juaj sëbashku me pedagogen ose pedagogun e kopështit të fëmijëve

Në bllokun „**Mein Kindergarten-Portfolio**“ ka vënd për vizatime, foto, përshkrime të përvojës së fituar që ka lënë mbresa tek fëmija juaj, thënjet e fëmijës tuaj, kërkimet e bëra nga fëmija juaj. Fëmija juaj është krenar, për ato gjëra që ka bërë dhe ato që ka mësuar .

Duke shikuar këtë **Portfolio** sëbashku me fëmijën tuaj, do të depërtoni në ato gjëra, që për fëmijën tuaj janë të rëndësishme dhe e bëjnë atë të gëzuar. Gëzohuni dhe ju sëbashku me fëmijën tuaj, për ato që ai ka arritur, për ato që ai mundet të bëjë si dhe për gjithçka që e bën atë krenar. Nëqoftëse dëshironi, jeni të ftuar që të sillni diçka në këtë **Portfolio**: foto dhe faqe familjare ose aktivitete të përbashkëta, që fëmija juaj ka dëshirë ti ketë aty brënda.

Në vitin e fundit në kopështin e fëmijëve, në atë parashkollor, fëmija juaj do të

pajiset me „**Kindergarten- Portfolio für die Schule**“ (Porfolio e kopështit për shkollën).

Kjo **ÜbergangsPortfolio** (Portfolio kalimtare) që do të shoqërojë kalimin nga kopështi në shkollë, do të shërbejë gjithashtu për ndërtimin e punës përgatitore për në shkollë. Ky bllok

do të japi edhe një ndihmë të çmuar, për bisedat që ju do të keni me mësuesit e shkollës.

Ju si prindër do të vendosni vetë, se cilat informacione që kanë të bëjnë me zhvillimin e fëmijës tuaj dhe që janë të figuruara në këtë bllok, doni të ekspozoni apo të tregoni në shkollë.

## **Portfolio në kopështin e fëmijëve**

### **Pse duhet Portfolio në kopështin e fëmijëve?**

#### **Për fëmijën tuaj**

- Zhvillimi dhe ndryshimet e fëmijës tuaj, do të perceptohen në mënyrë të ndërgjegjshme, me të gjitha ndryshimet dhe drejtimet zhvilluese, në atë shkallë ku ai qëndron.
- Fëmija juaj tregon interesat dhe përparësitë e veta.
- Stimulimi i proceseve mendore dhe hapja e mundësive të zhvillimit.
- Fëmija juaj do të stimulohet që mendimet dhe përvojën e tij ta përshkruajë me fjalë, si dhe të shkëmbejë mendimet me të tjerët.

#### **Për ju si prindër**

- Ju do të keni mundësinë të njiheni me jetën e përditëshme si dhe proceset mësimore të fëmijës tuaj në kopësht.
- Ju do të merrni më shumë informacione, për punën mësimore në kopështin e fëmijëve.
- Ju si prindër do të keni mundësinë, të merrni pjesë aktive në ndërtimin e Portfolios.
- Portfolio do tju shërbejë si dokument i çmuar, për bisedat e përbashkëta që do të bëni me pedagogët.

## **Drejtimi arsimor i emocioneve dhe marrdhënjeve sociale**

„Çfarë i forcon fëmijët“

Nga të dhënat e psikologjisë së zhvillimit, periudha e hershme feminare është bazë themelore e formimit të kompetencave njerëzore. Kopështi i afron fëmijës mundësinë e lëvizjes, në një bashkësi të madhe jo familjare si dhe vë në provë konfrontimin e tij me fëmijët e tjerë. Në situacionet e përditëshme si dhe gjatë lojës, fëmijët zhvillojnë strategjinë përballuese dhe vepruese, me qëllim që të dretojnë emocionet dhe impulset e tyre.

Fëmijët flasin, qeshin, zihen, për të verifikuar se çfarë baze të përbashkët ka loja me fëmijët e tjerë – ata zhvillojnë strategjinë e konfliktit , fitojnë njohuri për veten si dhe për të treguar veten tek të tjerët.

Bazën e kompetencave emocionale dhe shoqërore e përbëjnë:

Aftësia kontaktuese, vetkontrolli, marrja në konsideratë, mbrojtje e të drejtave, dëshira për të zbuluar. Kopështi i fëmijëve, ju afron atyre një mjedis jetësor dhe social të mbrojtur, që do ti ndihmojë ata për të zotëruar detyrat e vështira të zhvillimit dhe vetëdukimit social.

Edukimi social, është një faktor themelor që e bën fëmijën të ndjehet mirë si dhe kusht paraprak për motivimin dhe të kuptuarit të drejtimeve mësimore.

## **Drejtimi arsimor i marrdhënjeve emocionale dhe sociale**

Të mësuarit përmes përvojës emocionale dhe sociale

- Të njohurit e vetëdijshëm të ndjenjave
- Të mësuarit e rregullimit të emocioneve dhe ndjenjave
- Të ndjerit me tjetrin
- Zhvillimi i besimit, që vetja ime mund të ndryshoj diçka
- Zhvillimi i pavarësisë dhe ndërgjegjes
- Vënja e kufive, mundësia për të thënë dhe „JO“
- Të afruarit dhe të marrit e ndihmës
- Përpunimi i konflikteve
- Mbyllja e kompromiseve
- Caktimi i rregullave dhe normave të bashkjetesës dhe ndjekja e tyre
- Kapërcimi i periudhave kalimtare
- Kapërcimi aktiv dhe i vetëdijshëm i situatave të rënuara

### **Drejtimi arsimor i etikës, fesë dhe shoqërisë**

„ Çdo njeri është shumë pak si gjithë të tjerët, është pak si një pjesë e tyre, dhe është një pjesë si askush tjetër“

Në kopësht, fëmijët përballohen me vlera dhe norma të shoqërisë si dhe me njerëz që për sa i përket prejardhjes, fesë, traditave dhe aftësive individuale, janë të ndryshëm njëri me tjetrin.

**Vlerat** përbëjnë bazën e normave dhe veprimeve të njeriut .Është shumë e mundur që fëmijët në kopësht, të përjetojnë një sistem vlerash të ndryshme nga ato të familjes ku ai jeton. Kështu që ai do të konfrontohet, me veprime dhe norma të ndryshme. Nëqoftëse fëmijët ndihen të akceptuar në sistemin e vlerave familjare ku jetojnë, atëhere ju mundësohet më lehtë njohja me vlerat dhe normat e fëmijëve të tjerë.Në këtë mënyrë zhvillohet dhe baza themelore etike.

**Integracioni** në kuptimin pedagogjik, ju mundëson fëmijëve që me gjithë vlerat dhe aftësitë e ndryshme që kanë,të jenë pjesë e vlerësuar e grupit.Në këtë atmosferë, ku ndryshimet nga njëri-tjetri janë të vlerësuara, bëhet e mundur dhe ndjenja e sigurisë dhe përkatësisë.

Duke provuar format e ndryshme të vendosjes, fëmijët do munden që të marrin përgjegjësinë e duhur, për ndërtimin e jetës së përbashkët në grup. Ata do të mësojnë të formojnë mendimin e tyre personal, duke akceptuar dhe atë të të tjerëve si dhe të kërkojnë të drejtën e tyre, duke pranuar dhe atë të të tjeveve.

## **Drejtimi arsimor i etikës, fesë dhe shoqërisë**

Të mësuarit përmes përvojës së etikës, fesë dhe shoqërisë

- Të kuptuarit, se çdo njeri është njësoj i vlerësuar
- Njohja me të vërtetën, që shumëllojshmëria është pasuri
- Njohja me figurën e diferencuar dhe të shumëllojshme të rolit të burrit dhe gruas
- Njohja me sjelljet dhe parametrat demokratike
- Pjesmarrja aktive në vendimet e përbashkëta
- Akceptimi i vendimit të shumicës dhe ndjenjës së mbrojtjes për pakicën
- Përjetimi i festave dhe tregimeve fetare
- Takimi i hapur me kulturat dhe fetë e ndryshme, njohja e ndryshimeve

### **Drejtimi arsimor i gjuhës dhe komunikimit**

„ Gjuha është veshja e mendimeve“ (Samuel Johnson)

Gjuha është çelsi i komunikimit dhe arsimimit. Pedagogia ose pedagogu në kopështin e fëmijëve, përcakton programe të veçanta mësimore, për të zgjeruar kompetencat gjuhësore të fëmijëve dhe përdor situatat e përditëshme për mbështetjen e vazhdueshme të gjuhës. Këtu merr një domethënje të veçantë, dialogu mes fëmijëve dhe të rriturve: Ai përbën bazën e njohjes së interesave dhe nevojave të fëmijëve, për ti shoqëruar ata në mënyrë sa më individuale. Marrdhënjet pozitive shoqërore të fëmijëve dhe të rriturve si dhe siguria emocionale, është bazë për mësimin e suksesshëm të gjuhës. Mbështetja më e mirë për mësimin e gjuhës, bëhet përmes veprimit aktiv në situacionet e bisedave të përditëshme.

Shprehja „ **Literacy** „përmbledh të gjithë përvojën dhe aftësitë që fëmija mbledh nga librat, tregimet dhe kultura e të shkruajturit, përpara se ai vetë të ketë mësuar të shkruajë dhe të lexojë. Kopështi i fëmijëve afron një ambient stimulues letrar si dhe mundëson konfrontimin me tekste dhe literaturë të moshës fëminore.

Në procesin e shkrimit dhe leximit bazohet dhe aftësia për të kapur aspektet strukturore të gjuhës (vetëdija fonologjike). Mbështetja gjuhësore përmban gjithashtu: dëgjimin e zanoreve (p.sh.:në cilin emër dëgjojmë një A: Anna, Anton, Lisa), njohjen e rimave (p.sh.:Wanne,Tanne, Wald),ndarjen e fjalëve në rrokje (Sa-bi-ne).

**Shumëgjuhësia:** Gjuha e parë e fëmijëve ka një vlerë të veçantë.Gjuha familjare e meriton këtë vlerë, sepse gjuha dhe identiteti janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën. Përvetsimi i gjuhës së dytë bazohet në kompetencat e gjuhës së parë, prandaj është shumë e rëndësishme që gjuha e parë të zhvillohet vazhdimisht. Mundësia e kontaktit dhe e mësimin të gjuhëve të ndryshme në moshën

fëminore, është një pasuri për gjithë jetën.

## **Drejtimi arsimor i gjuhës dhe komunikimit**

### **Të mësuarit përmes përvojës gjuhësore**

- të mësuarit e natyrshëm të dy gjuhëve, i bazuar në formën e lojës dhe atë të përvojës
- Vënja në jetë e përkrahjes dhe vlerësimit të shumëgjuhësisë
- Njohja me librat dhe kulturën e të shkruajturit
- Zhvillimi i fjalorit dhe kompetecës së të treguarit
- Arritja „ që të lexohet me gëzim“
- Të kuptuarit e teksit dhe mendimit
- Interesi për shkrimin dhe të shkruajturit
- Mbështetje për bërjen e diferencimit akustik
- Mundësimi i të kuptuarit të strukturës gjuhësore: dëgjimi i zanoreve, njohja e rimave, etj
- Kompetenca për median

## **Drejtimi arsimor i lëvizjes dhe shëndetit**

„ Lëvizja është një formë elementare e të menduarit“ Gerd E. Schäfer

Lëvizja është një nga veprimet themelore dhe formë e të shprehurit të fëmijëve. Lëvizja luan funksion kryesor në kuadrin e zhvillimit të aftësive mendore, emocionale, sociale dhe komunikuese. Të mësuarit bazohet kryesisht në lëvizje dhe perceptim. Kopështi i fëmijëve afrojnë mundësi të shumta lëvizjesh, sugjerime dhe programe të planifikuara të lëvizjeve.

Fëmijët e perceptojnë botën përreth tyre, nëpërmjet trupit të tyre. Perceptim dmth, zgjedhja e disa prej përshtypjeve shqisore, interpretimi dhe përpunimi i tyre. Përmes perceptimit, fëmijët forcojnë aftësitë e tyre, orientohen, shprehen, ndërtojnë, ato janë kusht paraprak për mendimin dhe veprimin e strukturuar.

Nëpërmjet lëvizjeve fëmijët diferencojnë shkathtësinë, durimin e tyre, koordinimin dhe aftësinë e perceptimit të hapësirës. Duke provuar lëvizjet motorike fine dhe ato të trasha, fëmijët zhvillojnë më tutje ndjesinë dhe ndërgjegjsimin trupor.

Edukata fizike në kopështin e fëmijëve, përmbledh një sërë lëvizjesh të shumta si dhe të ushqyerit e shëndetshëm, ajo e bën fëmijën të ndërgjegjshëm, për gjithçka që trupit të njeriut i bën mirë dhe si të qëndrojë gjithmonë i shëndetshëm.

## **Drejtimi arsimor i lëvizjes dhe shëndetit**

### **Të mësuarit përmes përvojës së lëvizjeve**

- Zhvillimi i ndjesisë dhe ndërgjegjes trupore
- Dëshira për të lëvizur
- Njohja e kufijve të vetvetes
- Formimi i aftësive dhe koordinimit trupor (lëvizjet motorike fine dhe të trasha, orientimi në hapësirë, ritmi, ekuilibri etj,)
- Zhvillimi i një qëndrimi pozitiv ndaj trupit të vet
- Të diturit se çfarë i bën mirë trupit

## **Drejtimi arsimor i estetikës dhe ndërtimit**

„ Fëmijët janë arqitektët e të ardhmes“

Arsimimi estetik i bën fëmijët të aftë që të shprehin mendimet , idetë dhe fantazinë e tyre. Kopështi i fëmijëve afron një ambient nxitës, ku fëmijët mund të zhvillojnë kreativitetin e tyre në formë musikore, lëvizore, gjuhësore dhe prezantuese.

Çdo shprehje artistike, është një pjesë e zhvillimit të përvojës dhe fantazisë. Arti i jep gjuhës një mënyrë tjetër komunikimi, ai lind nga pyetjet e dala për botën që na rrethon, nga analiza e vetvetes si dhe nga eksperimentet me materiale dhe forma të ndryshme.

Në kopësht, fëmijët kanë mundësinë të njihen me vepra të artit, me artistë dhe artiste, me vlera artistike të kulturës së tyre si dhe të kulturave të huaja.

Përmes proceseve krijuese, fëmijët përjetojnë efektin e të bërit vetë të diçkaje, gjë kjo që kontribon në mënyrë të konsiderueshme në zhvillimin e identitetit të tij.

## **Arqitektura dhe ndërtimi i ambientit**

Njerzit kërkojnë, që ambienti që i rrethon të jetë nxitës për shqisat dhe ndjenjat e tij.

Arqitektura dhe pedagogjia ndihmojnë mjaft në këtë drejtim. Në ambiente e strukturuara qartë, të mbushura me shumëllojshmëri si dhe mundësi për tu takuar me të tjerë, fëmijët mund të lëvizin të lirë sapo të kenë mësuar sistemin e rregullave. Ambienti luan rolin e „pedagogut të tretë“.

### **Drejtimi arsimor i estetikës dhe ndërtimit**

Të mësuarit nëpërmjet estetikës dhe ndërtimit

- Aftësia e ndërgjegjësuar e mënyrës së të shprehurit
- Zbulimi i të dhënave të vetvetes
- Krijimi i ambienteve të duhura, për të nxitur fantazinë dhe kreativitetin
- Krijimi artistik i shikuar si proces shoqëror
- Të drejtuarit e fëmijëve drejt ndjenjave estetike
- Njohja e parë me muzikën dhe artin e figuruar

## **Drejtimi arsimor i natyrës dhe teknikës**

„ Fëmijë zbulojnë botën që i rrethon“

Fëmijë janë kuriozë: ata duan të zbulojnë, eksperimentojnë, kërkojnë, konstruktojnë duke kërkuar përgjigje për pyetjet e tyre. Është detyrë e kopështit që të ndihmojë, kuriozitetin e natyrshëm të fëmijëve për numrat, natyrën, teknikën si dhe eksperimentet fizike e kimike, me qëllim që proceset e piksynuara mësimore të nxiten sa më herët.

Shumë „ Pse-pyetje“ të fëmijës, i drejtohen fenomeneve të shkencave të natyrës dhe teknikës. „ Pse del ylberi?“, „ Pse disa sende ngjiten tek magneti? “ – Fëmijët duan të kuptojnë fenomenet e përditëshme, por ata janë të varur nga ato gjëra që shikojnë dhe eksperimentojnë. Përmes eksperimentit dhe vëzhgimit të fenomeneve të gjalla dhe jo të gjalla të natyrës, fëmija siguron hyrjen në temat e shkencave të natyrës. Ai mëson ligjet dhe vetitë biologjike, kimike, fizike dhe teknike të fenomeneve.

Nëqoftëse fëmija nuk merr përgjigje të shpejtë për këto pyetje, po merr mundësinë që ti zbulojë vetë përgjigjet, atëhere këto përgjigje dhe këto mësimet do të mbeten të regjistruara për gjithë jetën. Kureshtja e ndezur, do ta nxiti fëmijën për pyetje dhe vëzhgime të tjera.

Përjetimi dhe ndeshja me fenomenet e natyrës dhe të botës që e rrethon, do të zhvillojë tek fëmija ndjenjën e rëndësisë dhe brishtësisë së ekuilibrit ekologjik. Fëmija përjeton se natyra dhe ambienti që na rrethon duhet mbrojtur dhe secili nga ne ka detyrën e vet në këtë drejtim, me qëllim që botën ta trashëgojnë edhe gjeneratat që do vinë.

## **Drejtimi arsimor i natyrës dhe teknikës**

### **Të mësuarit përmes përvojës me natyrën dhe teknikën**

- Përjetimi i natyrës
- Të kuptuarit e fenomeneve të natyrës
- Mbrojtja e vlerave të natyrës dhe ambientit
- Njohja në formë loje e ligjeve biologjike, kimike dhe fizike të natyrës
- Njohja e parë me ligjet e matematikës :
  - Krahasimi Sasi – Masë
  - Njohja me marrdhënjet e hapësirës
  - Lidhja: Sasia – numrat - shifrat

### **Kolektivi i kopështit të fëmijëve**

**Drejtoria** e kopështit ka për detyrë, të drejtojë dhe administrojë kopështin e fëmijëve dhe kolektivin pedagogjik si dhe mban përgjegjësinë për të gjithçka që bëhet në kopësht.

**Pedagogia** ose **pedagogu drejtues i grupit në kopështin e fëmijëve**, duke u bazuar në aftësitë dhe kërkesat e fëmijëve, ju afron atyre mundësinë e mësimit dhe lëvizjes në ambientet e caktuara. Përmes piksynimeve të ndryshme pedagogjike si dhe në një atmosferë të mirëbesuar, do të ndihmohet më së miri zhvillimi i fëmijës tuaj.

**Ndihmësja** ose **ndihmësi i grupit**, mbështet punën mësimore të pedagoges ose pedagogut të grupit.

Ka dhe një **pedagoge** ose **pedagog tjetër të veçantë**, që sëbashku me pedagogen ose pedagogun e grupit, mbështet më shumë ata fëmijë që kanë nevoja të veçanta, me piksynimin që edhe këta fëmijë të forcojnë aftësitë dhe zhvillimin e tyre .

**Bashkpunorja** ose **bashkpunori interkulturore** mbështet sëbashku me pedagogen ose pedagogun e grupit, të mësuarit e natyrshëm të gjuhës të atyre fëmijëve që vinë nga kultura të tjera. Këta fëmijë përjetojnë se përmes shumëgjuhësisë së tyre, janë pjesa intergruese e grupit dhe në këtë mënyrë ndikojnë në rritjen e kompetencës së mësimt të gjuhës, për të gjithë fëmijët.

### **Përgjegjësit në Gemeinde**

Gemeinde është zotëruesi i kopështit të fëmijëve dhe përgjegjës për

- regjistrimin e fëmijës tuaj
- punësimin e kujdestarëve, kujdestareve dhe fuqisë puntore ndihmëse
- ndërtimin ,objektin dhe pajisjet e kopështit të fëmijëve
- fiksimin e orarit të kopështit, i cili caktohet sipas kërkesave tuaja
- kujdesjen e fëmijëve edhe gjatë pushimeve
- organizimin e drekës
- fiksimin dhe mbledhjen e pagesave
- marrëveshjen për rastet e integracionit

## Pyetjet për kopështin e fëmijëve

Për ju si prindër, kopështi i fëmijëve është vëndi i parë i informacionit dhe bisedës.

Pedagogia apo pedagogu i grupit ose drejtorja e kopështit, do të shikojnë dhe merren me çështjet tuaja.

Për pyetje dhe çështje të tjera, do tju luteshim të drejtoheni në inspektoriatin përkatës të lagjes ku jetoni:

Bezirk	Adresse	Telefon
<b>AMSTETTEN</b>	3300 Amstetten, Preinsbacherstraße 11	07472/9025/10530
<b>BADEN</b> (ohne die Gemeinden des ehemaligen Gerichtsbezirkes Ebreichsdorf*)	2500 Baden, Schwarzstraße 50	02252/9025/11610
<b>BRUCK/LEITHA</b> (mit den Gemeinden des ehemaligen Gerichtsbezirkes) Ebreichsdorf*)	2460 Bruck/Leitha, Fischamender Straße 10	02162/9025/11207
<b>GÄNSERNDORF</b>	2230 Gänserndorf, Schönkirchner Straße 1	02282/9025/10226
<b>GMÜND</b>	3910 Zwettl, Am Statzenberg 1	02822/9025/11438
<b>HOLLABRUNN</b>	3580 Horn, Frauenhofner Straße 2	02982/9025/11317
<b>HORN</b>	3580 Horn, Frauenhofner Straße 2	02982/9025/11317
<b>KORNEUBURG</b>	2100 Korneuburg, Bankmannring 5	02262/9025/11217
<b>KREMS, KREMS-STADT</b>	3500 Krems, Drinkweldergasse 15	02732/9025/11381
<b>LIILENFELD</b>	3270 Scheibbs, Rathausplatz 5	07482/9025/11246
<b>MELK</b>	3390 Melk, Abt Karl-Straße 23	02752/9025/11405
<b>MISTELBACH</b>	2130 Mistelbach, Hauptplatz 4/5	02572/9025/11245
<b>MÖDLING</b>	2340 Mödling, Bahnstraße 2	02236/9025/11495
<b>NEUNKIRCHEN</b>	2620 Neunkirchen, Peischinger Straße 17	02635/9025/10310
<b>SCHEIBBS</b>	3270 Scheibbs, Rathausplatz 5	07482/9025/11246
<b>ST. PÖLTEN</b>	3109 St. Pölten, Am Bischofteich 1	02742/9025/37840
<b>ST. PÖLTEN-STADT</b>	3270 Scheibbs, Rathausplatz 5	07482/9025/11246
<b>TULLN</b>	3430 Tulln, Hauptplatz 33	02262/9025/11299
<b>Waidhofen/YBBS</b>	3270 Scheibbs, Rathausplatz 5	07482/9025/11246
<b>Waidhofen/Thaya</b>	3910 Zwettl, Am Statzenberg 1	02822/9025/11438
<b>WR. NEUSTADT</b>	2700 Wr. Neustadt, Ungargasse 33	02622/9025/11307
<b>WR. NEUSTADT-STADT</b>	2700 Wr. Neustadt, Ungargasse 33	02622/9025/11307
<b>WIEN UMGEBUNG</b>	3400 Klosterneuburg, Leopoldstraße 21	02243/9025/10309

**ZWETTL**

3910 Zwettl, Am Statzenberg 1

02822/9025/11438

Amt der NÖ Landesregierung, Abteilung Kindergärten, Wiener Straße 54, Stiege B, Tor zum Landhaus,  
3109 St. Pölten, Tel: 02742/9005/13238, Fax: 02742/9005/13595, E-Mail: [post.k5@noel.gv.at](mailto:post.k5@noel.gv.at),  
Internet: <http://www.noel.gv.at/Kindergarten>

---

\*Die Gemeinden des ehemaligen Gerichtsbezirkes Ebreichsdorf heißen Ebreichsdorf, Günselsdorf,  
Oberwaltersdorf, Pottendorf, Reisenberg, Seibersdorf, Teesdorf, Trumau, Blumau-Neurißhof,  
Mitterndorf an der Fischa und Tattendorf

## Literatur

Bildungsplan für Kindergärten in Niederösterreich

[www.noe.gv.at/kindergarten](http://www.noe.gv.at/kindergarten)

NÖ Kindergartengesetz 2006

LGBl. 5060 in der derzeit geltenden Fassung

[www.noe.gv.at/kindergarten](http://www.noe.gv.at/kindergarten) Ruprik: Kindergartenrecht in NÖ

**Impressum:** Herausgeber und Medieninhaber: Amt der NÖ Landesregierung, Abt. Kindergärten, Tor zum Landhaus, Wiener Straße 54, 3109 St. Pölten; Redaktion: Dr. Renate Steger, Eva Stundner, MA, Mag. Doris Kirchner; Grafik: Helmut Kindlinger; Fotos: Edition Lammerhuber; Produktion und Anzeigenverwaltung: Druckservice Muttenthaler GmbH, Ybbser Straße 14, 3252 Petzenkirchen.